

III. UDHA E DREJTË LA RETTA VIA



Onufri: Shpërftyrimi i Zotit Krisht

Onufrio: Trasfigurazione di Nostro Signore



III. UDHA E DREJTË

Që të jesh njeri i ri, burrë i drejtë o grua e nderuar, Ynë Zot ta mësoi udhën. Një ditë një trim e pyeti: « Mjeshtër, çfarë të mirë më duhet të bëj për të fituar jetën e pasosur »?

Dhe Ynë Zot iu përgjegy: « Nëse do të hysh në jetë, ruaj urdhërimet » (Mt. 19,16-17).

A. URDHËRIMET E T'YNË ZOTI

130. I riu: Ç' janë urdhërimet e t'Ynë Zoti?

Prifti: Urdhërimet e Perëndisë ose dekalogu, janë rregullat morale që Ynë Zot në Testamentin e Vjetër ia dha Moisiut në malin e Sinait, kur i liroi Hebrenjtë nga Faraoni i Egjiptit dhe i solli në dheun e premtuar.

131. I riu: Cilat janë urdhërimet e Perëndisë?

Prifti: Urdhërimet e t'Ynë Zoti janë dhjetë:

1. Unë jam Zoti Perëndia Yt; nuk do të kesh perëndi tjetër përveç meje;
2. Mos e përmend pa nder emrin e Perëndisë;
3. Mba mend të shenjtërosh festat;

III. LA RETTA VIA

Perché tu sia nuova creatura, uomo giusto o donna onorata, nostro Signore ha insegnato la via. Un giovane gli chiese un giorno: « Maestro, che cosa di buono devo fare per avere la vita eterna? ». Nostro Signore gli rispose: « Se vuoi entrare nella vita, osserva i comandamenti » (Mt. 19,16-17).

A. I COMANDAMENTI DI DIO

130. Il giovane: Cosa sono i comandamenti di Dio?

Il sacerdote: I comandamenti di Dio, o decalogo, sono le regole morali che Nostro Signore, nell'Antico Testamento, ha dato a Mosé sul Monte Sinai, quando ha liberato gli ebrei dal faraone d'Egitto e li ha condotti alla terra promessa.

131. Il giovane: Quali sono i comandamenti di Dio?

Il sacerdote: I comandamenti di Dio sono dieci:

- 1) Io sono il Signore Dio tuo, non avrai altro Dio fuori che me;
- 2) Non nominare con disonore il nome di Dio;
- 3) Ricordati di santificare le feste;

4. Ndero atin tënd dhe mëmën tënde;
5. Mos vrit;
6. Mos shkel besën e martesës;
7. Mos vidh;
8. Mos bëj dëshmi të rreme;
9. Mos dëshiro gruan e tjetrit;
10. Mos dëshiro gjërat e të tjerëve.

132. I riu: *Këto urdhërime kanë vlerë edhe sot për ne të krishterët?*

Prifti: Po. Ne jemi të detyruar t'i ruajmë urdhërimet e Perëndisë, sepse Fjala e Perëndisë vlen përgjithmonë edhe sepse Zoti Krisht i konfirmoi këto urdhërime me fjalën dhe me veprën e tij. Ynë Zot tha: « Nuk erdha që ta shlyej ligjin, por që ta përmbush » (Mt. 5,17).

133. I riu: *Urdhërimet e përmbajnë të tërë ligjin?*

Prifti: Urdhërimet japin vetëm rregullat më të nevojshme me karakter të përgjithshëm dhe themelor.

Zoti Krisht i interpretoi në një mënyrë më të plotë (Mt. 5-6). Urdhërimet i japin të krishterit rregullat se si duhet të sillet ndaj t'Ynë Zoti dhe ndaj të afërmit. Tri të parat urdhërime na thonë se si duhet të sillemi ndaj Perëndisë; kurse shtatë të tjerat na mësojnë si duhet të sillemi ndaj njerëzve. Një ditë Zoti Krisht përmbodhi domethënien e ligjit në dy fjalë. « Një mësues i ligjit e pyeti: cili është më i madhi urdhërim i ligjit?

Jezusi u përgjigj: *Duaje Zotin, Perëndinë tënd, me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd, me gjithë mendjen tënde.* Ky

4. Onora tuo padre e tua madre;
5. Non uccidere;
6. Non commettere adulterio;
7. Non rubare;
8. Non testimoniare il falso;
9. Non desiderare la donna d'altri;
10. Non desiderare la roba degli altri.

132. Il giovane: *Questi comandamenti hanno valore ancora oggi per noi cristiani?*

Il sacerdote: Sì. Noi siamo tenuti ad osservare i comandamenti di Dio, perché la parola di Dio ha valore per sempre e perché Nostro Signore Gesù Cristo li ha confermati con la sua parola e la sua opera. Nostro Signore ha detto: « Non sono venuto per abolire la legge, ma per darle compimento » (Mt. 5,17).

133. Il giovane: *I comandamenti contengono tutta la legge?*

Il sacerdote: I comandamenti danno soltanto le norme essenziali con carattere generale e fondamentale. Gesù Cristo le ha interpretate in maniera più piena (Mt. capp. 5-6).

I comandamenti indicano al cristiano come si deve comportare verso il Signore e verso il prossimo. I primi tre ci insegnano come dobbiamo comportarci verso Dio, mentre gli altri sette verso il prossimo.

Gesù Cristo, un giorno, ha sintetizzato in due affermazioni il significato di tutti i comandamenti.

« Un maestro della legge gli chiese: qual è il comandamento più grande della legge? Gesù rispose: *Amerai il Signore Dio tuo con*

është më i madhi dhe i pari urdhërim. I dyti është i barabartë me të: *Duaje të afërmin tënd porsi vetveten*. Nga këto dy urdhërime varet i tërë ligji dhe profetët» (Mt. 22,36-40).

134. I riu: *Si janë të organizuara urdhërimet?*

Priifti: Të gjitha urdhërimet varen nga i pari: « Unë jam Zoti, Perëndia yt ». Pa këtë, të tjerat nuk do të kishin forcë. Forca e tyre vjen nga Zoti, Perëndia i vërtetë, i vetmi Perëndi. Urdhërimet varen dhe shpjegohen me të parin, kështu: « Ti, mos vrit, pse unë jam Perëndia yt »; « Ti mos vidh, pse unë jam Perëndia yt »; « Ti mos bëj dëshmi të rreme, pse unë jam Perëndia yt », që e njeh të vërtetën.

Kështu edhe për urdhërimet e tjera.

tutto il tuo cuore, con tutta la tua anima e con tutta la tua mente. E il secondo è simile al primo: *Amerai il prossimo tuo come te stesso*. Da questi due comandamenti dipende tutta la legge e i profeti » (Mt. 22, 36-40).

134. Il giovane: *Come sono strutturati i comandamenti?*

Il sacerdote: Tutti i comandamenti dipendono dal primo « Io sono il Signore Dio tuo ». Senza di questo, gli altri non avrebbero forza alcuna. Questa proviene dal Signore, Iddio vero, l'unico Dio. I comandamenti dipendono e si spiegano con il primo in questo modo: « Non uccidere, perché io sono il tuo Dio »; « Non rubare, perché io sono il tuo Dio »; « Non fare falsa testimonianza, perché io sono il tuo Dio » che conosce la verità.

È così anche per gli altri comandamenti.

« Unë jam Zoti, Perëndia yt; nuk do të kesh tjetër Perëndi përveç meje ».

135. I riu: Ç'na mëson urdhërimi i parë?

Prifti: Urdhërimi i parë ka dy pjesë. E para thotë: « Unë jam Zoti, Perëndia yt »; e dyta: « Nuk do të kesh tjetër Perëndi përveç meje ». Të dyja bashkë na mësojnë monoteizmin, domethënë se Perëndia është një i vetëm dhe s'ka tjetër Perëndi përveç Atij.

136. I riu: Ç'na mëson pjesa e parë « Unë jam Zoti, Perëndia yt »?

Prifti: Vërtet kjo pjesë nuk është urdhër, por zbulesa e Perëndisë. Perëndia na zbulohet dhe na thotë se Perëndia është një i vetëm. Ai na thotë edhe se është Zoti i njeriut, domethënë ai që krijoi njeriun dhe e ndihmon dhe e do me zemër gjithmonë.

137. I riu: Ç'na mëson e dyta pjesë « nuk do të kesh tjetër Perëndi përveç meje »?

Prifti: Në formë mohore përsëritet ajo që ishte thënë në pjesën e parë: një është Zoti, një është Perëndia, Perëndia i vërtetë, Perëndia yt.

Por e dyta pjesë na thotë edhe më shumë: na ndalon që të krijojmë ne perëndi të rreme. Nuk duhet të adhurojmë tjetër perëndi përveç Perëndisë të vërtetë.

« Io sono il Signore, Dio tuo; non avrai altro Dio fuori che me ».

135. Il giovane: Cosa ci insegna il primo comandamento?

Il sacerdote: Il primo comandamento ha due parti.

La prima dice: « Io sono il Signore, Dio tuo », e la seconda: « Non avrai altro Dio fuori che me ». Entrambe insieme inculcano il monoteismo, cioè che Dio è uno solo e non ve ne sono altri al di fuori di Lui.

136. Il giovane: Cosa ci insegna la prima parte: « Io sono il Signore, Dio tuo »?

Il sacerdote: In verità questa parte non è un comandamento, ma la rivelazione di Dio. Il Signore stesso si rivela e ci dice che Dio è uno solo. Ci dice anche che egli è il Signore dell'uomo, vale a dire colui che ha creato l'uomo e lo sostiene e lo ama sempre.

137. Il giovane: Cosa ci insegna la seconda parte: « Non avrai altro Dio fuori che me »?

Il sacerdote: In forma negativa si ripete ciò che viene dichiarato nella prima parte: uno è il Signore, uno è Iddio, il Dio vero, il tuo Dio.

Ma la seconda parte ci aggiunge qualcosa: proibisce a noi di creare falsi dei. Non bisogna adorare altri dei al di fuori del Dio vero.

138. I riu: *Ç'janë perënditë e rreme?*

Prifti: S'janë asgjë. Nuk ekzistojnë. I krijon fantazia e njeriut. Prandaj edhe quhen « perëndi të rreme ». Por në kohë të shkuara disa popuj adhuronin shumë perëndi, jetonin në politeizëm. Disa adhuronin zjarrin, diellin, hënën... Këta janë idhuj, perëndi të rreme.

139. I riu: *Ka sot edhe popuj që adhurojnë perëndi të rreme?*

Prifti: Po. Ka popuj që ende s'e kanë njohur besën e krishterë dhe adhurojnë idhuj dhe perëndi të rreme. Pastaj janë disa që e konsiderojnë shtetin, pushtetin si perëndi që i mban të nënshtruar njerëzit. Disa të tjerë mbajnë si idhuj pasuritë ose të hollat. Ka shumë idhuj modernë që duan t'ia zënë vendin Perëndisë.

140. I riu: *Ka nga ata që thonë se Perëndia nuk ekziston?*

Prifti: Gjithmonë ka pasur nga ata që nuk kanë besuar. Ka edhe sisteme filozofike që thonë se Perëndia nuk ekziston. Kanë organizuar edhe shtete me filozofi ateiste. Historia ka provuar se atje ku s'njihet Perëndia, humbet edhe dinjiteti i njeriut.

Ata që thonë se Perëndia nuk ekziston, Bibla i mban për të marrë, pa mendje. Por edhe këtyre Perëndia u thotë: «Unë jam Zoti, Perëndia juaj, ai që i do me zemër njerëzit».

138. Il giovane: *Cosa sono i falsi dei?*

Il sacerdote: Non sono nulla. Non esistono. Li crea la fantasia dell'uomo. Per questo si dicono « falsi dei ». Nel passato molti popoli adoravano vari dei, vivevano nel politeismo. Alcuni adoravano il fuoco, il sole, la luna... Questi sono idoli, falsi dei.

139. Il giovane: *Ci sono ancora oggi popoli che adorano falsi dei?*

Il sacerdote: Sì. Ancora oggi ci sono popoli che non hanno conosciuto la fede cristiana e adorano idoli e falsi dei. Vi sono poi alcuni che considerano lo stato, il potere, come divinità che tengono sottomessi gli uomini.

Alcuni altri considerano la ricchezza alla stregua di idolo. Vi sono molti idoli moderni che tentano di prendere il posto di Dio.

140. Il giovane: *Ci sono di quelli che dicono che Dio non esiste?*

Il sacerdote: Sempre ci sono state persone che non hanno avuto alcuna fede. Ci sono anche dei sistemi filosofici che asseriscono che Dio non esiste. Si sono pure organizzati degli stati con filosofie ateistiche. Ma la storia ha provato che là dove si nega Dio, si perde anche la dignità dell'uomo. Coloro che dicono che Dio non esiste, la Bibbia li chiama stolti. Ma anche a questi Iddio dice: « Io sono il Signore, Dio tuo, colui che ama gli uomini ».

141. I riu: *A ka popuj të tjerë që e mbajnë monoteizmin?*

Prifti: Po. Bashkë me të krishterët janë monoteistë hebrenjtë dhe muhamedanët. Edhe ata adhurojnë vetëm një Perëndi. Dhe kjo i lidh në një marrëdhënie të ngushtë me të krishterët.

Me hebrenjtë të krishterët kemi lidhje të veçanta pse besa e krishterë u zhvillua në ambientin hebraik. Jezu Krishti, apostujt, Shën Mëria nga Nazarethi, ishin hebrenj. Me hebrenjtë ne të krishterët kemi së bashku Testamentin e Vjetër.

Muhamedanët kanë një traditë fetare të vetë. Por edhe me ta na bashkon besa se ekziston një Perëndi i vetëm.

Të krishterët respektojnë ndërgjegjen e çdo njeriu. Sot kërkojnë të jetojnë në harmoni me besimtarët e tjerë nëpërmjet dialogut dhe bashkëpunimit, për të mirën e të gjithë njerëzve.

141. Il giovane: *Ci sono altri popoli che osservano il monoteismo?*

Il sacerdote: Sì. Assieme ai cristiani sono monoteisti gli ebrei e i musulmani. Anche essi adorano un solo Dio. E questo li mette in una stretta relazione con i cristiani. Con gli ebrei abbiamo rapporti spirituali speciali perché la fede cristiana si sviluppa nell'ambiente ebraico. Gesù Cristo, gli apostoli, Maria di Nazaret, erano ebrei.

Con gli ebrei noi cristiani abbiamo insieme l'Antico Testamento.

I musulmani hanno una propria tradizione religiosa. Ma anche con essi ci accomuna la fede nell'unico Dio.

Il cristiano rispetta la coscienza di ognuno. E oggi si cerca di vivere assieme agli altri in armonia, promuovendo il dialogo e la collaborazione per il bene dell'umanità.

«Mos e permend pa nder emrin e Perëndisë».

142. I riu: Ç'na mëson urdhërimi i dytë?

Prifti: Forma e urdhërimeve është mohore: «mos e përmend emrin e Perëndisë pa nder», «Mos vidh», «Mos vrit»... por qëllimi që kërkohet të arrihet është pohor. Urdhërimet duan të na mësojnë udhën e drejtë. Kështu urdhërimi i dytë na mëson se duhet ta përmendemi emrin e t'Ynë Zoti, gjithmonë me nder e me dashuri.

143. I riu: Pse duhet ta përmendemi me nder emrin e Perëndisë?

Prifti: Sepse Ai është Zoti Ynë, Ai na krijoi, na mban në jetë, na do me zemër. Pastaj duhet të kemi parasysh se mendja jonë s'mund të kuptojë plotësisht madhësitinë e t'Ynë Zoti. Ai është Perëndi i parrëfyeshëm dhe i pakuptueshëm. Liturgjia na thotë se asnjëri nga ne që jemi të lidhur me dëshirat e kurmit është i denjë t'i afrohet ose t'i shërbejë Perëndisë. Edhe për këtë emri i t'Ynë Zoti duhet ta përmendet me nder të madh.

144. I riu: Ç'na ndalon urdhërimi i dytë?

Prifti: Urdhërimi i dytë na ndalon mallkimin. Disa mallkojnë t'Ynë Zot dhe shenjtoret. Ata nëmin emrin e t'Ynë Zoti. Jo vetëm që s'e nderojnë, por ia dëshirojnë të keqen. Ky urdhërim e ndalon edhe beti-

« Non nominare con disonore il nome di Dio »

142. Il giovane: Cosa ci insegna il secondo comandamento?

Il sacerdote: La forma dei comandamenti è negativa. « Non nominare il nome di Dio con disonore », « Non rubare », « Non uccidere »... Ma il loro scopo è positivo. I comandamenti vogliono indicare la retta via. Così il secondo comandamento ci insegna che il nome di Dio deve essere nominato sempre con rispetto e con amore.

143. Il giovane: Perché bisogna nominare con rispetto il nome di Dio?

Il sacerdote: Perché egli è il Signore Nostro, ci ha creato, ci mantiene in vita, ci ama. Inoltre dobbiamo avere presente che la nostra mente non è capace di comprendere pienamente la grandezza di Dio. Egli è ineffabile e incomprendibile.

La liturgia ci dice che nessuno che sia legato ai desideri della carne è degno di avvicinarsi o di servire il Signore. Anche per questo il nome di Dio deve essere nominato con grande riverenza.

144. Il giovane: Cosa proibisce il secondo comandamento?

Il sacerdote: Il secondo comandamento proibisce la bestemmia. Alcuni bestemmiano Dio e i Santi. Maledicono il nome di Dio. Non solamente non lo onorano, ma gli desiderano il male. Questo comandamento ci

min e rremë mbi emrin e Perëndisë. Në betimin e rremë mirret Ynë Zot për dëshmi të rreme. Nuk nderohet kështu emri i t'Ynë Zoti.

145. I riu: *I dyti urdhërim ndalon edhe hipokrizinë sociale?*

Prifti: I dyti urdhërim ndalon çdo hipokrizi. Shumë herë nën emrin e Perëndisë mbulohen iniciativa që s'kanë të bëjnë me besën. Përdoret besa për punë të pabesë. Edhe kështu emri i t'Ynë Zoti përmendet pa nder.

proibisce anche il giuramento falso sul nome di Dio. Nel giuramento falso si prende Dio per testimone del falso. Non si onora così il nome di Dio.

145. Il giovane: *Il secondo comandamento proibisce anche l'ipocrisia sociale?*

Il sacerdote: Il secondo comandamento proibisce ogni ipocrisia. Molte volte sotto il nome di Dio si coprono iniziative che non hanno nulla a che fare con la fede. Si sfrutta la fede per opere da infedeli. Anche così il nome di Dio viene nominato senza rispetto.

« Mba mend të shenjtërosh festat ».

146. I riu: Ç'na mëson i treti urdhërim?

Prifti: I treti urdhërim na kujton se ne kemi një lidhje të ngushtë me t'Ynë Zot. Këtë lidhje duhet ta shprehim gjithmonë, por në mënyrë më të dukshme në ditët e festave të Tij.

147. I riu: Ç'na ndalon i treti urdhërim?

Prifti: Bibla na rrëfen se Ynë Zot, kur krijoi jetën, punoi për gjashtë ditë dhe në të shtatën pushoi. Kështu duhet të veprojë edhe besimtari. Një ditë në javë ai nuk duhet të punojë. I krishteri s'punon të dielën, ditën kur Zoti Krisht u ngjall nga të vdekurit. Këtë ditë i krishteri ia kushton lutjes, studimit të Shkrimeve të Shenjta, familjes së tij. E diela duhet të jetë një ditë pushimi dhe hareje.

Kjo ditë nënkupton atë që njeriu duhet të jetë i lirë nga puna. Puna është për nevojat e njeriut dhe s'duhet ta nënshtrojë njeriun. E tërë java orientohet ndaj së dielës, ditës së Zotit, ditës së lirisë.

148. I riu: Si duhet t'i shenjtërojmë festat?

Prifti: Festat duhen shenjtëruar jo vetëm me pushimin, por edhe me një vepër kulturi veçanërisht me celebrimin e liturgjisë eu-

« Ricordati di santificare le feste ».

146. Il giovane: Cosa ci insegna il terzo comandamento?

Il sacerdote: Il terzo comandamento ci ricorda che abbiamo uno stretto legame con Dio. E bisogna che esprimiamo questo legame sempre, ma in modo più manifesto nei giorni delle sue feste.

147. Il giovane: Cosa ci proibisce il terzo comandamento?

Il sacerdote: La Bibbia ci narra che Dio, quando creò il mondo, ha lavorato per sei giorni e il settimo si è riposato. Così deve comportarsi il credente. Un giorno la settimana deve riposare. Il cristiano non lavora la domenica, il giorno in cui Gesù Cristo è risorto dai morti. Questo giorno il cristiano lo dedica alla preghiera, allo studio delle Sacre Scritture, alla propria famiglia. La domenica deve essere una giornata di riposo e di gioia.

Questo giorno indica che l'uomo deve essere libero dal lavoro. Il lavoro serve alle necessità dell'uomo e non lo deve rendere schiavo. L'intera settimana è orientata alla domenica, al giorno del Signore, al giorno della liberazione.

148. Il giovane: Come si santifica la festa?

Il sacerdote: La festa si santifica non soltanto con il riposo, ma anche con il culto: specialmente con la celebrazione della litur-

haristike që përkujton vdekjen dhe ringjalljen e Krishtit.

Mesha është karakteristika e parë e së dielës dhe e të festave të tjera. Çdo i krishterë me familjen e tij duhet të shkojë në meshë. Të gjithë bashkë marrim pjesë në kungim. Dhe duke marrë pjesë të gjithë në një bukë, të gjithë bashkohemi në një kurm. Kështu rritet familja në jetën shpirtërore. Dhe merr formë kisha si komunitet paqeje dhe dashurie.

Festa na kujton se s'jemi të vetëm. Ynë Zot është bashkë me ne, dhe gjithkush është bashkë me tjetrin.

gia eucaristica che commemora la morte e la resurrezione di Cristo.

La celebrazione eucaristica è la caratteristica principale della domenica e delle altre feste. Ogni cristiano, assieme alla sua famiglia è tenuto a parteciparvi. Insieme prendiamo parte alla comunione. E partecipando tutti a un solo pane, tutti siamo uniti in un solo corpo. Cresce così la famiglia nella vita spirituale e si costruisce la chiesa come comunità di pace e di amore.

La festa poi ci ricorda che non siamo soli. Il Signore è con noi e ognuno è assieme agli altri.

« *Ndero atin tënd dhe mëmën tënde* ».

149. I riu: *Ç'na mëson i katërti urdhërim?*

Prifti: Prindërit na sollën në jetë, pas urdhërimit që Ynë Zot i dha Adamit dhe Evës: « Rrituni dhe shumëzohuni, mbulonit dheun ».

Prindërit jo vetëm na sollën në jetë, por na rritën dhe na edukuan. Meritojnë nderin dhe dashurinë tonë.

Kështu duhet t'i ndihmojmë prindërit kur kanë nevojë, duhet t'i ruajmë kur janë të sëmurë, t'u shërbejmë kur janë pleq.

Duhet të dëgjojmë fjalët e tyre, që na mësojnë udhën e drejtë. Shën Pali na thotë: « Ju, fëmijë, dëgjoni prindërit tuaj në emrin e Zotit pse kjo është gjë e drejtë » (Ef. 6,1).

150. I riu: *Ç'na ndalon i katërti urdhërim?*

Prifti: Ky urdhërim na ndalon t'i braktisim prindërit dhe t'i lëmë pa ndihmën dhe dashurinë tonë. Na ndalon t'i qortojmë se disa herë nuk e kuptojnë kohën tonë dhe problemet e të rinjve. Nga ana tjetër prindërit s'duhet të sillen ashpër me fëmijët. Thotë Shën Pali: « Ju, prindër, mos i lodhni fëmijët tuaj, por ndihmojini të rriten me rregull, duke i mësuar sipas shpirtit të Zotit » (Ef. 6,4).

« *Onora tuo padre e tua madre* ».

149. Il giovane: *Cosa ci insegna il quarto comandamento?*

Il sacerdote: I genitori ci hanno portato alla vita, come il Signore ha ordinato ad Adamo ed Eva: « Crescete e moltiplicatevi, riempite la terra ».

I genitori non soltanto ci hanno dato la vita, ma ci hanno aiutato a crescere, ci hanno educato. Meritano quindi il nostro rispetto e il nostro amore.

Occorre offrire loro l'aiuto ogni volta che ne hanno bisogno, occorre assisterli quando sono ammalati, occorre accudirli nella loro vecchiaia. È doveroso ascoltare le loro parole che ci indicano la retta via. Scrive S. Paolo: « Voi figli, obbedite ai vostri genitori nel Signore, perché questo è giusto » (Ef. 6,1).

150. Il giovane: *Cosa ci proibisce il quarto comandamento?*

Il sacerdote: Questo comandamento ci proibisce di lasciare i genitori soli e senza il nostro aiuto e il nostro affetto. Ci proibisce di disprezzarli perché talvolta non comprendono il nostro tempo e i problemi dei giovani. D'altra parte i genitori non devono comportarsi con asprezza verso i figli. Dice S. Paolo: « Voi genitori non inasprite i vostri figli, ma allevateli nell'educazione e nella disciplina del Signore » (Ef. 6,4).

151. I riu: *Si e konsideron Bibla këtë urdhërim?*

Prifti: Bibla e konsideron me rëndësi të madhe. Ky është i pari urdhërim pas atyre që flasin për t'Ynë Zot. Prindërit tanë janë njerëzit tanë më të afërt.

Urdhërimi i tërë në Biblën thotë: « Ndero atin tënd dhe mëmën tënde, si të ka urdhëruar Perëndia, që të kesh jetë të gjatë dhe hare mbi dhe » (Deut. 5,16).

Nderimi i prindërve është i lidhur me premtimin për një jetë të gjatë me hare.

152. I riu: *Edhe Zoti Krisht e konfirmoi këtë urdhërim?*

Prifti: Po. Ai jo vetëm i konfirmoi, por edhe i plotësoi të gjitha urdhërimet. Pra edhe këtë.

Për Zotin Krisht dashuria ndaj Perëndisë është parim absolut. Edhe nderimi ndaj prindërve është i rregulluar nga dashuria ndaj t'Ynë Zoti. Nga dashuria ndaj Perëndisë merr frymë edhe nderimi ndaj prindërve. Kur dashuria ndaj prindërve largohet nga Perëndia nuk është nderim i vërtetë. Zoti Krisht tha: « Ai që do atin e tij dhe mëmën e tij më tepër se mua, s'është i denjë për mua » (Mt. 10,37).

151. Il giovane: *Come la Bibbia considera questo comandamento?*

Il sacerdote: La Bibbia gli dà una grande considerazione. È il primo comandamento dopo quelli che si riferiscono a Dio. I genitori sono il nostro prossimo più vicino. Il comandamento nella sua espressione integrale nella Bibbia, dice: « Onora tuo padre e tua madre, come Dio ti ha comandato, perché la tua vita sia lunga e tu sia felice nel paese che il Signore tuo Dio ti dà » (Deut. 5,16).

Il rispetto dei genitori è legato alla promessa di una vita lunga e felice.

152. Il giovane: *Gesù Cristo ha confermato questo comandamento?*

Il sacerdote: Sì. Egli ha confermato tutti i comandamenti, e li ha tutti completati. Così anche questo. Per Gesù Cristo l'amore di Dio è il principio assoluto. Anche il rispetto dei genitori è diretto dall'amore di Dio. Da questo amore verso Dio viene ispirato anche il rispetto verso i genitori. Quando l'amore verso i genitori allontana da Dio, non è vero rispetto. Nostro Signore Gesù Cristo ha detto: « Chi ama il padre e la madre più di me, non è degno di me » (Mt. 10,37).

« Mos vrit ».

153. I riu: *Ç'na mëson urdhërimi i pestë?*

Prifti: Jeta është një dhuratë e t'Ynë Zoti. Ai na krijoi dhe na mban në jetë me ndihmën e tij.

Mbi jetën e njeriut Ynë Zot vuri dorën e tij. Kur Kaini vrau Abelin, të vëllain, Ynë Zot i tha: « Gjaku i tyt vëllai thërret nga nën dhe gjer tek unë » (Gjen. 4,10). Për këtë Kaini trembej se ndokush mund ta vriste, por Ynë Zot, i vuri një shenjë në ballë, që të mos e vriste njeri. E tha: « Nëse njeri vret Kainin, do të jetë i rrahur shtatë herë kaq » (Gjen. 4,15). Ky fakt na thotë se askush nuk mund të vrasë, pse jeta vjen nga Zoti.

154. I riu: *Ç'na ndalon urdhërimi i pestë?*

Prifti: Ky urdhërim ndalon çdo vrasje të njeriut.

Ai na ndalon edhe të rrahim të tjetët dhe t'i shajmë.

I afërmi duhet respektuar si vëlla.

Ky urdhërim na ndalon edhe vetëvrasjen. Askush nuk mund të vrasë veten, pse jeta nuk është jona por e t'Ynë Zoti. Ky urdhërim ndalon edhe abortin. Njeriu i vogël o i madh, trim o plak, burrë o grua, ka gjithmonë të njëjtën vlerë. Askush nuk mund ta vrasë. Mbi njeriun rri dora e Perëndisë.

« Non uccidere ».

153. Il giovane: *Cosa ci insegna il quinto comandamento?*

Il sacerdote: La vita è un dono di Dio. Egli ci ha creato e ci mantiene in vita con la sua provvidenza. Sulla vita dell'uomo nostro Signore ha posto la sua protezione.

Quando Caino ha ucciso suo fratello Abele, il Signore disse: « La voce del sangue di tuo fratello grida a me da sottoterra » (Gen. 4,10). Per questo Caino temeva che qualcuno potesse ucciderlo, ma il Signore impose un segno sulla sua fronte perché non lo colpisse nessuno. E disse: « Se qualcuno ucciderà Caino, subirà la vendetta sette volte » (Gen. 4,15).

Questo episodio ci dice che nessuno può uccidere, perché la vita proviene da Dio.

154. Il giovane: *Cosa ci proibisce il quinto comandamento?*

Il sacerdote: Questo comandamento proibisce ogni uccisione dell'uomo.

Ci proibisce anche di malmenare gli altri o di disprezzarli. Il prossimo deve essere rispettato come un fratello.

Questo comandamento proibisce anche il suicidio. Nessuno può uccidersi, perché la vita non è nostra, ma di Dio.

Questo comandamento proibisce anche l'aborto. L'uomo, piccolo o grande, giovane o vecchio, uomo o donna, ha sempre lo stesso valore. Nessuno può ucciderlo. Sull'uomo vi è la mano di Dio.

155. I riu: *Zoti Krisht për këtë urdhërim ka thënë diçka më shumë?*

Prifti: Zoti Krisht tha: « E keni dëgjuar se u qe thënë të vjetërve: *Mos vrit*, dhe ai që vret do të jetë i dënuar në gjyq. Po unë ju them juve, se kushdo që zemërohet kundër të vëllait të vet, do të dënohet në gjyq. Kush do t'i thotë të vëllait: « Ti je pa tru », do të dërgohet në gjykimin e Sinedrit; dhe kush do t'i thotë « I marrë », do të dënohet në zjarrin e Gjeenës » (Mt. 5,21-22). Kështu ndalohet jo vetëm vrasja fizike, por edhe ajo morale dhe sharja e të afërmit. E keqja lind në zemrën e njeriut.

155. Il giovane: *Gesù Cristo per questo comandamento ha aggiunto qualche cosa d'altro?*

Il sacerdote: Nostro Signore Gesù Cristo disse: « Avete sentito che fu detto agli antichi: *non uccidere*, chi avrà ucciso sarà sottoposto a giudizio. Ma io vi dico: chiunque si adira contro il proprio fratello, sarà sottoposto a giudizio. Chi poi dice al fratello: stupido, sarà sottoposto al sinedrio; e chi gli dice: pazzo, sarà sottoposto al fuoco della Geenna » (Mt. 5,21-22). In tal modo si proibisce non soltanto l'uccisione fisica, ma anche quella morale e il disprezzo del prossimo. Il male nasce dal cuore dell'uomo.

« Mos shkel besën e martesës ».

156. I riu: Ç'na mëson urdhërimi i gjashtë?

Prifti: Ky urdhërim do të ruajë njësinë e familjes së themeluar në martesë. Kurvëria shkallmon martesën dhe ndan familjen. Ky urdhërim mbron dinjitetin dhe të drejtat e familjes dhe ruan shenjtërinë e kurmit të njeriut që është banesë e Shpirtit të Shenjtë (I Kor. 6,19).

157. I riu: Ç'ndalon ky urdhërim?

Prifti: Ky urdhërim ndalon marrëdhëniet seksuale jashtë martesës. Këto marrëdhënie janë të padrejta ndaj gruas ose burrit të martuar, dhe s'mbajnë besën e dhënë në martesë.

Ky urdhërim ndalon edhe marrëdhëniet seksuale përpara martesës dhe të gjithë ato vepra o mendime që afrojnë rrezikun e marrëdhënieve seksuale jashtë martesës.

158. I riu: Zoti Krisht ç'na thotë më shumë?

Prifti: Ynë Zot tha: « Keni dëgjuar se u është thënë të vjetërve: *Mos kurvëro*. Po unë ju them: kush shikon një grua për ta dëshiruar, atëherë ai ka kurvëruar me atë në zemër të vet » (Mt. 5,6-7). Si për vrasjen, edhe këtu Zoti Krisht e sjell problemin te rrënja e tij, te zemra e njeriut. Ai e do të pastër zemrën e njeriut.

« Non commettere adulterio ».

156. Il giovane: Cosa ci insegna il sesto comandamento?

Il sacerdote: Questo comandamento vuole salvaguardare l'unità della famiglia che è fondata sul matrimonio. L'adulterio rovina il matrimonio e divide la famiglia.

Questo comandamento difende la dignità e i diritti della famiglia e protegge la santità del corpo umano che è tempio dello Spirito Santo (I Cor. 6,19).

157. Il giovane: Cosa proibisce il sesto comandamento?

Il sacerdote: Questo comandamento proibisce i rapporti sessuali extraconiugali. Essi sono ingiusti verso l'uomo e la donna sposati, non mantengono la fedeltà promessa nel matrimonio. Questo comandamento proibisce anche le relazioni sessuali prima del matrimonio e tutte le azioni e pensieri che avvicinano il pericolo dei rapporti sessuali fuori del matrimonio.

158. Il giovane: Cosa ci dice in più Gesù Cristo?

Il sacerdote: Gesù Cristo disse: « Avete sentito che fu detto: *non commettere adulterio*; ma io vi dico: chiunque guarda una donna per desiderarla, ha già commesso adulterio nel suo cuore » (Mt. 5,27-28). Come per l'omicidio, anche qui Gesù Cristo porta il problema alla sua radice, nel cuore dell'uomo. Egli vuole puro il cuore dell'uomo.

« *Mos vidh* ».

159. I riu: *Ç'na mëson urdhërimi i shtatë?*

Prifti: Gjërat e të tjerëve janë të të tjerëve. Dhe respekti që i duhet të afërmit, i përket edhe gjërave të tij. Kushdo ka të drejtën të ngrejë një shtëpi, të blejë një copë toke, të organizojë një treg. Kushdo është i zoti të mirret me punën që do dhe që i jep më sukses ekonomik o kulturor. Frytet e këtyre punëve janë të atyre që i bëjnë. Janë shfaqje të urtësisë dhe të mundimit të tyre.

Ashtu si duhet respektuar njeriu, kështu duhet respektuar edhe puna e tij dhe frytet e punës.

160. I riu: *Ç'na ndalon ky urdhërim?*

Prifti: Ky urdhërim na ndalon të vjedhim, domëthënë t'i marrim pronën ndonjeriut padrejtësisht. Ndalohet edhe t'i bëjmë dëm gjërave të tij. Bibla na e kujton me disa shembuj.

Bibla na thotë: « Mos ndërro kufijtë e të afërmit tënd, të vënë nga pleqtë, në dheun që do të marrësh » (Deut. 19,14). Në qoftë se bën dëm, duhet t'i paguash. Bibla thotë: « Nëse ndonjë dërgon dhentë e tij te dheu o te vreshta e të afërmit dhe i bën

« *Non rubare* ».

159. Il giovane: *Cosa ci insegna il settimo comandamento?*

Il sacerdote: I beni degli altri sono degli altri. Il rispetto che dobbiamo al prossimo, lo dobbiamo anche alle sue cose. Chiunque ha il diritto di costruirsi una casa, di comprarsi un pezzo di terra, di organizzare un commercio. Chiunque può darsi all'attività che vuole e che gli porta maggiore successo economico o culturale. I frutti di queste attività appartengono a coloro che le realizzano. Sono il risultato della loro intelligenza e del loro lavoro.

Come si deve rispettare l'uomo, così si deve rispettare anche il suo lavoro e i suoi frutti.

160. Il giovane: *Cosa ci proibisce questo comandamento?*

Il sacerdote: Questo comandamento ci proibisce di rubare, cioè di sottrarre ingiustamente ciò che appartiene agli altri. Ci proibisce anche di recare danno alle cose del prossimo. La Bibbia ci ricorda alcuni esempi: « Non sposterai i confini posti dai tuoi antenati nell'eredità che ti sarà toccata » (Deut. 19,14). Nel caso che arrechi dei danni a qualcuno dovrai ricompensarlo. Dice la Bibbia: « Quando un uomo lascia che il suo bestiame vada a pascolare nel campo o nella vigna del prossimo e causa danni, deve dare l'indennizzo con il

dëme, ai duhet ta paguajë dëmin me vreshtën e tij » (Ex. 22,4).

161. I riu: *Ky urdhërim ka të bëjë edhe me marrëdhëniet shoqërore dhe politike?*

Prifti: Po. Ky urdhërim duhet të rregullojë edhe këto marrëdhënie. Individit mund të vjedhë shoqërinë o shtetin. Dhe shteti mund të vjedhë individin.

Ata që punojnë në administratën publike mund të prierin fshehurazi të mirën e të gjithëve në interesin privat, qofshin pasuri o të mira të tjera. Ai që paguhet për të punuar, dhe s'punon, vjedh atë që e pagan.

Edhe shteti mund të vjedhë individin. E vjedh kur nuk ia respekton të drejtat, kur s'e pagan siç duhet, kur i lyp taksa më të rënda se sa është e drejtë, kur s'e lejon të zhvillohet në kulturë dhe në iniciativat e tij. Shteti e vjedh individin, kur për interesa politike fsheh të vërtetën ose nuk ndreq padrejtësinë shoqërore. Të gjitha këto janë të ndaluara nga urdhërimi i shtatë.

162. I riu: *Cila është vjedhja më e madhe që shteti mund t'i bëjë individit?*

Prifti: Vjedhja më e madhe që shteti i bën individit është kur shteti i merr popullit lirinë. Pa liri të gjithë të drejtat e tjera vihen nën këmbë. Atëherë populli është në robëri, si dikur hebrenjtë në Egjipt nën Faraonin, nga ku i liroi Moisiu me ndihmën e Perëndisë.

meglio del suo campo e con il meglio della sua vigna » (Ex. 22,4).

161. Il giovane: *Questo comandamento ha a che fare con i rapporti sociali e politici?*

Il sacerdote: Sì. Questo comandamento deve regolare anche questi rapporti. L'individuo può rubare alla società o allo stato. Lo stato può defraudare l'individuo.

Quelli che lavorano nell'amministrazione pubblica possono stornare di nascosto il bene comune per interesse privato, si tratti di denaro o di altri beni.

Colui che riceve un salario per un lavoro e non lavora, egli ruba a colui che lo paga. Anche lo stato può derubare l'individuo. Lo deruba quando non rispetta i suoi diritti, quando non lo paga per quanto è dovuto, quando impone tasse più pesanti del giusto, quando gli impedisce di svilupparsi culturalmente o nelle sue iniziative.

Lo stato defrauda l'individuo, quando, per interessi politici, nasconde la verità e non ristabilisce la giustizia sociale. Tutto ciò è contrario al settimo comandamento.

162. Il giovane: *Qual è il furto maggiore che lo stato può fare all'individuo?*

Il sacerdote: Il furto maggiore che lo stato fa all'individuo è quello di togliere la libertà al popolo. Senza libertà tutti gli altri diritti vengono calpestati. Allora il popolo è nella schiavitù, come un tempo gli Ebrei sotto il faraone, da dove Mosè, con l'aiuto di Dio, li ha liberati.

« Mos bëj dëshmi të rreme ».

163. I riu: Ç'na mëson urdhërimi i tetë?

Prifti: Ky urdhërim na mëson të jemi dëshmitarë vetëm të së vërtetës, sepse Zoti Krisht është e Vërteta.

Si bij të Perëndisë, ne të krishterët, duhet të themi gjithmonë të vërtetën. Duhet ta bëjmë këtë edhe kur s'na vjen mirë.

Veçanërisht duhet të themi të vërtetën kur mund të ndihmojmë të tjerët.

164. I riu: Ç'na ndalon ky urdhërim?

Prifti: Ky urdhërim na ndalon të bëjmë dëshmi të rreme ndaj t'Ynë Zoti dhe ndaj të afërmit.

Ynë Zot na lyp të jemi dëshmitarë të tij në tërë jetën (Veprat 1,8). Për këtë na dërgoi Shpirtin e Shenjtë. Kjo dëshmi duhet të jetë si dritë pa të errët.

Tha Ynë Zot: « Kështu le të shkëlqejë drita juaj para njerëzve, që të shohin veprat tuaja të mira e ta lavdërojnë Atin tuaj që është në qiell » (Mt. 5,16).

Ky urdhërim na ndalon edhe dëshminë e rreme kundër të afërmit. Nuk duhet t'i bëjmë keq të afërmit. Për këtë duhet të ruhem nga çdo fjalë që mund t'i bëjë keq nderit të tij. Kështu duhet të ruhem nga çdo hipokrizi.

« Non testimoniare il falso ».

163. Il giovane: Cosa ci insegna l'ottavo comandamento?

Il sacerdote: Questo comandamento ci insegna ad essere testimoni soltanto della verità, perché nostro Signore Gesù Cristo è la Verità. Come figli di Dio, bisogna che noi cristiani diciamo sempre la verità. Occorre fare così anche quando per noi non è comodo. In particolare dobbiamo testimoniare la verità quando così possiamo aiutare il prossimo.

164. Il giovane: Cosa ci proibisce questo comandamento?

Il sacerdote: Questo comandamento ci proibisce di fare falsa testimonianza verso Dio e verso il prossimo. Nostro Signore ci chiede di essere suoi testimoni nel mondo intero (Atti 1,8). E per questo ci ha mandato lo Spirito Santo. Questa testimonianza deve essere come luce senza oscurità.

Ha detto Nostro Signore: « Così risplenda la vostra luce davanti agli uomini, perché vedano le vostre opere buone e rendano gloria al Padre nostro che è nei cieli » (Mt. 5,16).

Questo comandamento ci proibisce anche di fare falsa testimonianza a scapito del prossimo. Non dobbiamo fare del male al prossimo. Per questo dobbiamo guardarci da ogni parola che può far danno al suo onore. Bisogna ugualmente evitare ogni ipocrisia.

165. I riu: Ç'na lyp më shumë Zoti Krisht?

Prifti: Zoti Krisht tha: « Keni dëgjuar se u qe thënë të vjetërve: « Mos bëj betim mbi të rremen, por bëj atë që i premtove Zotit ». Unë ju them juve: mos bëni fare betim as mbi qiellin pse ai është froni i Perëndisë, as mbi dheun, pse ky është vendi ku Ai vë këmbët e tij... Mos bëj betim as mbi kryet e tu, pse ti s'je i zoti ta bësh të zezë a të bardhë një qime. Fjala jote të jetë: « Po, po; jo, jo », pse çdo gjë më shumë se kaq vjen nga djalli » (Mt. 5,33-37).

165. Il giovane: Cosa ci chiede di più Nostro Signore Gesù Cristo?

Il sacerdote: Gesù Cristo disse: « Avete sentito che è stato detto agli antichi: non spergiurare, ma adempi con il Signore i tuoi giuramenti; ma io vi dico: non giurate affatto né per il cielo perché è il trono di Dio, né per la terra perché è lo sgabello dei suoi piedi... Non giurare neppure per la tua testa, perché non hai il potere di rendere bianco o nero un solo capello. Sia invece il vostro parlare: « sì, sì; no, no »; il più viene dal maligno » (Mt. 5,33-37).

« Mos dëshiro gruan e tjetrit ».

166. I riu: Ç'na mëson urdhërimi i nëntë?

Prifti: Çdo mëkat zë fill në zemër të njeriut, prandaj edhe zemra duhet të jetë e pastër. Tha Ynë Zot: « Nga zemra vijnë mendimet e këqia, vrasjet, tradhëtitë në martesë, kurvëritë, vjedhjet, dëshmitë e rreme, mallkimet dhe janë këto që e përlyejnë njeriun » (Mt. 15,19-20).

167. I riu: Ç'na ndalon urdhërimi i nëntë?

Prifti: Ky urdhërim ndalon të dëshirohet gruaja e të tjerëve. Kështu ndalon edhe grave të dëshirojnë burrin e të tjerave. Urdhërimi i gjashtë thotë të mos kurvërosh, urdhërimi i nëntë ndalon edhe dëshirën për kurvëri. Ky urdhërim kërkon ta shkulë rrënjën e mëkatit, ta lirojë njeriun nga ngasja e parë, e fshehur në zemrën e tij.

« Non desiderare la donna d'altri ».

166. Il giovane: Cosa ci insegna il nono comandamento?

Il sacerdote: Ogni peccato ha origine nel cuore dell'uomo. Per questo bisogna che il cuore sia puro. Disse il Signore: « Dal cuore provengono i propositi malvagi, gli omicidi, gli adulterii, le fornicazioni, i furti, le false testimonianze, le bestemmie. Queste sono le cose che rendono immodo il cuore dell'uomo ». (Mt. 15,19-20).

167. Il giovane: Cosa ci proibisce questo comandamento?

Il sacerdote: Questo comandamento proibisce di desiderare la donna degli altri. Ugualmente proibisce che le donne desiderino il marito di un'altra donna. Il sesto comandamento dice di non commettere adulterio, il nono comandamento proibisce anche il desiderio dell'adulterio. Questo comandamento vuole estirpare la radice stessa del male, vuole liberare l'uomo dalla prima tentazione nascosta nel suo cuore.

« Mos dëshiro gjërat e të tjerëve ».

168. I riu: Ç'na mëson urdhërimi i dhjetë?

Prifti: « Çdokush tundohet nga dëshira » (Japku, 1,14). Dhe dëshira turbullon zemrën e njeriut.

Shkruan Shën Japku: « Ju keni plot dëshira, dhe nuk arrini të keni atë që dëshironi. Për këtë vritni njerëz, keni zili për gjërat e të tjerëve që s'mund të hidhni në dorë, për këtë ziheni dhe bëni luftëra » (Japku, 4,2). Prandaj duhet të kemi kujdes të madh për dëshirat. Ato mund të shtien njeriun në pisë, në ferr, duke e ndërruar jetën e tij në një helm të paprerë.

Ky urdhërim na mëson të edukojmë vullnetin tonë në respektin ndaj të tjerëve dhe ndaj gjërave të tyre.

169. I riu: Ç'na ndalon urdhërimi i dhjetë?

Prifti: Urdhërimi i shtatë thotë « Mos vidh » i dhjeti ndalon edhe dëshirën për gjërat e të tjerëve, sepse ato janë të të tjerëve. Nga ana tjetër ai ndalon edhe dëshirën për pasuri të pamatur. Pse kjo ia turbullon mendjen e njeriut dhe ia helmon zemrën duke ia larguar paqen. Zoti Krisht tha: « Ç'i vlen njeriut të fitojë jetën e tërë, ndëse pra humb shpirtin e tij? Ç'do t'i japë njeriu në vend të shpirtit të tij? » (Mk. 8,36-37).

170. I riu: Ç' thotë më shumë Zoti Krisht?

Prifti: Shën Pali na kujton kështu mësimin e Zotit Krisht: « Ata që kanë pasuri, le të

« Non desiderare la roba degli altri ».

168. Il giovane: Cosa ci insegna il decimo comandamento?

Il sacerdote: « Ciascuno è tentato dalla propria concupiscenza » (Giac. 1,14). E la concupiscenza sconvolge l'animo umano. Scrive S. Giacomo: « Bramate e non riuscite a possedere e uccidete; invidiate e non riuscite ad ottenere; combattete e fate guerra » (Giac. 4,2).

Perciò dobbiamo guardarci dalla concupiscenza. Essa può condurre l'uomo all'inferno, trasformando già da ora la sua vita in dolore continuo. Questo comandamento ci insegna ad educare la nostra volontà, a rispettare gli altri e le loro cose.

169. Il giovane: Cosa ci proibisce il decimo comandamento?

Il sacerdote: Il settimo comandamento dice « Non rubare », il decimo proibisce anche di desiderare la roba degli altri, perché appartiene ad altri. D'altra parte proibisce anche di desiderare ricchezze smisurate, perché queste sconvolgono la mente dell'uomo e rattristano il suo cuore privandolo della pace. Gesù Cristo ha detto: « Che giova infatti all'uomo guadagnare il mondo intero, se poi perde la sua anima? » (Mc. 8,36-37).

170. Il giovane: Che dice inoltre Gesù Cristo?

Il sacerdote: S. Paolo ci ricorda in questi termini l'insegnamento di Gesù Cristo:

rrojnë sikurse s'kanë » (I Kor. 7,30). Ideali i Zotit Krisht është liria nga çdo lidhje e nga çdo kujdes i tepruar për jetën.

Zoti Krisht tha: « Mos kini kujdes për jetën tuaj, se ç'do të hani e ç'do të pini; as për kurmin tuaj, me ç'ta vishni. Vëreni zogjtë e qiellit; ata nuk mbjellin, nuk korrin, nuk mbledhin, dhe Ati juaj që është në qiell u jep të hanë. Ju nuk vleni më shumë se zogjtë? Prandaj mos u shqetësoni duke thënë: çka do të hamë, çka do të pimë, me çka do të vishemi? Të gjitha këto i kërkon gjindja e pabesë...

Kërkoni më parë mbretërinë e Perëndisë dhe drejtësinë e tij, dhe këto të gjitha do t'ju jepen më shumë » (Mt. 6,25-26. 31-33).

171. I riu: *Këto janë urdhërimet e Perëndisë. Duhet t'i ruajmë. Por në qoftë se njeri s'i ruan çfarë do të ndodhë?*

Prifti: I krishteri që vullnetarisht dhe me dijëni nuk ruan urdhërimet e Perëndisë fajësohet përpara Perëndisë, bën mëkat. Mëkati është një faj kundër Perëndisë, nuk u bindemi urdhërimeve të Perëndisë, dhe kështu shkelim ligjin e t'Ynë Zoti ose veprimë kundër dogmave të kishës. Njeriu bie në mëkat me mendje, me veprime, me fjalë, me harresë.

« Coloro che vengono in possesso di ricchezze, vivano come se non ne possedessero » (I Cor. 7,30). L'ideale di Gesù Cristo è la libertà da ogni legame e da ogni preoccupazione eccessiva per la vita.

Gesù Cristo disse: « Per la vostra vita non affannatevi per quello che mangerete o berrete e neanche per il vostro corpo di quello che indosserete; la vita forse non vale più del cibo e il corpo più del vestito? Guardate gli uccelli del cielo: non seminano, né mietono, né ammassano nei granai; eppure il Padre vostro celeste li nutre. Non contate voi forse più di loro?... Non affannatevi dunque dicendo: che cosa mangeremo, che cosa berremo, che cosa indosseremo? Di tutte queste cose si preoccupano i pagani... Cercate prima il regno di Dio e la sua giustizia e tutte queste cose vi saranno date in aggiunta » (Mt. 6, 25-26; 31-33).

171. Il giovane: *Questi sono i comandamenti del Signore. Bisogna osservarli. E se uno non li osserva?*

Il sacerdote: Il cristiano che volontariamente e con deliberata coscienza non osserva i comandamenti di Dio, pecca di fronte a Dio, commette peccato.

Il peccato è appunto una colpa contro Dio, una disubbidienza alla sua legge, quando si calpestano le sue norme o quando si opera contro i dogmi della chiesa. Si può peccare con la mente, con le parole, con le opere e per le omissioni.

Zoti Krisht e plotësoi ligjin e Perëndisë dhe i shpalli të bekuar e të lumtur ata që e ruajnë. Sintezën e ligjit e bëri duke premtuar disa lumturi.

172. I riu: *Cilat janë këto lumturi?*

Prifti: Ato gjenden në Vangjelin e Shën Matheut (5,3-12) kështu:

1. Të lumët të varfrit në shpirt, sepse e tyre është mbretëria e qiejve.
2. Të lumët ata që qajnë, sepse do të ngushëllohen.
3. Të lumët ata që janë të butë, sepse ata do ta trashëgojnë dheun.
4. Të lumët ata që kanë uri dhe etje për drejtësi, ata do të kenë atë që dëshirojnë.
5. Të lumët ata që ndiejnë mëshirë, sepse do të gjejnë mëshirë.
6. Të lumët ata që kanë zemrën e pastër, sepse ata do të shohin Perëndinë.
7. Të lumët ata që punojnë për paqen, sepse ata do të quhen bij të Perëndisë.
8. Të lumët ata që janë të përzënë për shkak të drejtësisë, sepse e tyre është mbretëria e qiejve.
9. Të lumët jini ju kur për mua ju shajne dhe ju përzënë, kur ju thonë çdo fjalë të keqe me të rreme, për emrin tim. Gëzohi dhe kini hare sepse i madh do të jetë shpërblimi juaj në qiell.

Nostro Signore Gesù Cristo ha portato a compimento la legge di Dio e ha promesso la beatitudine e la felicità a coloro che la osservano. La sintesi della legge egli l'ha fatta con alcune beatitudini.

172. Il giovane: *Quali sono queste beatitudini?*

Il sacerdote: Esse si trovano nel Vangelo di S. Matteo (5,3-12) così:

1. Beati i poveri di spirito, perché di essi è il regno dei cieli.
2. Beati gli afflitti, perché saranno consolati.
3. Beati i miti, perché erediteranno la terra.
4. Beati quelli che hanno fame e sete di giustizia, perché saranno saziati.
5. Beati i misericordiosi, perché troveranno misericordia.
6. Beati i puri di cuore, perché vedranno Dio.
7. Beati gli operatori di pace, perché saranno chiamati figli di Dio.
8. Beati i perseguitati per causa della giustizia, perché di essi è il regno dei cieli.
9. Beati voi quando vi insulteranno, vi perseguiteranno e mentendo diranno ogni sorta di male contro di voi per causa mia. Rallegratevi ed esultate, perché grande è la ricompensa nei cieli.

173. I riu: *Këto lumturi janë shumë të bukura, por duken shumë të rënda. Si mund të ruheshen?*

Prifti: Jezu Krishti na tha: kush do të vijë pas meje, le të marrë kryqin e tij dhe të vijë me mua. I krishteri e di mirë se Ai që e thirri i jep edhe fuqinë që ta ndjekë pas. Për atë që ka besë, gjithçka është e mundur, në emrin e Zotit.

173. Il giovane: *Queste beatitudini sono molto belle, ma sembrano molto difficili. Come si possono osservare?*

Il sacerdote: Gesù Cristo ha detto: chi vuole venire dietro di me prenda la sua croce e mi segua. Il cristiano sa bene che colui che lo ha chiamato gli dà anche la forza per seguirlo. Per colui che ha fede tutto è possibile nel nome del Signore.



Ngjitja në qiell e Zotit Krisht

Ascensione al cielo di Gesù Cristo



Të gjithë Shenjtorët me Krishtin

Tutti i Santi con Cristo

Jezu Krishti do të vijë përsëri me lavdi që të gjykojë të gjallët dhe të vdekurit; dhe mbretëria e tij nuk do të ketë mbarim.

174. I riu: *Ne kemi besë në të gjitha ato të vërteta që na mësoi Ynë Zot. Ne ruajmë të gjitha urdhërimet që na la. Ç'do të bëhet për ne?*

Prifti: Edhe këtë na e zbuloi Zoti Krisht kur u shpjegoi dishepujve si do të jetë dita e fundit, kur ai do të vijë të gjykojë të gjallët dhe të vdekurit.

175. I riu: *Si do të jetë ajo ditë?*

Prifti: Vangjeli i Shën Matheut thotë kështu: « Kur të vijë i Biri i njeriut në lavdinë e vet, dhe të gjithë engjëjt bashkë me Të, atëherë Ai do të ulet mbi fronin e lavdisë së tij. Përpara Tij do të mbledhen të gjithë popujt. Ai do të ndajë njerin nga tjetri, ashtu si bariu ndan dhentë nga cjeptë. Dhentë do t'i vëjë në të djathtë dhe cjeptë në të majtë. Atëherë mbreti do t'u thotë atyre që janë në të djathtë e tij: « Eja në të bekuarit e Atit tim, trashëgoni mbretërinë e përgatitur për ju që kur ishte krijuar jeta. Pse pata uri dhe më keni dhënë të haja; pata etje dhe më keni dhënë të pija; isha i huaj dhe më keni mbledhur në shtëpinë tuaj; isha i zhveshur dhe më keni veshur, i sëmurë dhe keni ardhur të më shihni, isha në burg dhe erdhët tek unë ». Kështu të drejtët do t'i përgjigjen atij dhe t'i thonë: « O Zot, kur të kemi parë të

Gesù Cristo verrà di nuovo nella gloria per giudicare i vivi e i morti; e il suo regno non avrà fine.

174. Il giovane: *Noi crediamo in tutte queste verità che ci ha insegnato Gesù Cristo. Osserviamo tutti i comandamenti che ci ha dato. Che sarà di noi?*

Il sacerdote: Anche questo ci ha rivelato Nostro Signore Gesù Cristo, quando ha spiegato ai discepoli come sarà l'ultimo giorno, quando verrà a giudicare i vivi e i morti.

175. Il giovane: *Come sarà quel giorno?*

Il sacerdote: Il Vangelo di Matteo dice così:

« Quando il Figlio dell'uomo verrà nella sua gloria con tutti i suoi angeli, si siederà sul trono della sua gloria. E saranno riunite davanti a lui tutte le genti, ed egli separerà gli uni dagli altri, come il pastore separa le pecore dai capri, e porrà le pecore alla sua destra e i capri alla sinistra. Allora il re dirà a quelli che stanno alla sua destra: Venite, benedetti del Padre mio, ricevete in eredità il regno preparato per voi fin dalla fondazione del mondo. Perché io ho avuto fame e mi avete dato da mangiare, ho avuto sete e mi avete dato da bere; ero forestiero e mi avete ospitato, nudo e mi avete vestito, malato e mi avete visitato, carcerato e siete venuti a trovarmi. Allora i giusti gli risponderanno: Signore, quando

vdekur urie dhe të kemi dhënë për të ngrënë? Të etur, dhe të kemi dhënë të pije? Kur të kemi parë të huaj dhe të kemi sjellë në shtëpitë tona; të zhveshur dhe të kemi veshur? Kur të kemi parë të sëmurë dhe në burg dhe erdhëm tek ti?»

Mbreti do t'u përgjigjet kështu: « Me të vërtetë ju them juve, çdo herë që t'ia keni bërë njërit ndër këta vëllezër të mi më të vegjël, ma keni bërë mua ».

Pastaj do t'u thotë atyre që janë në të majtë: « Ikni, larg nga unë, të mallkuar, ecni në zjarr të pasosur të përgatitur për djallin dhe për engjëjt e tij. Sepse pata uri dhe s'më dhatë të haja, pata etje dhe s'më dhatë të pija; isha i huaj dhe s'më qasët në shtëpitë tuaja; isha i zhveshur dhe s'më veshët, i sëmurë dhe në burg dhe s'erdhët tek unë ». Atëherë do t'i përgjigjen edhe ata duke thënë: « O Zot, kur të pamë të vdekur urie, të djegur etjeje, të huaj, të zhveshur, ose të sëmurë, ose në burg dhe nuk të shërbyem?

Këtu Ai do të përgjigjet me këto fjalë: « Me të vërtetë ju them juve: sa herë nuk ia bëtë ndonjërit ndër këta më të vegjël, s'ma keni bërë mua ». Dhe këta do të venë në pisë, në mundim të pasosur dhe të drejtët në jetën pa mbarim » (Mt. 25,31-46).

mai ti abbiamo veduto affamato e ti abbiamo dato da mangiare, assetato e ti abbiamo dato da bere? Quando ti abbiamo visto forestiero e ti abbiamo ospitato, o nudo e ti abbiamo vestito? E quando ti abbiamo visto ammalato o in carcere e siamo venuti a visitarti? Rispondendo, il re dirà loro: In verità vi dico: ogni volta che avete fatto queste cose a uno solo di questi miei fratelli più piccoli, l'avete fatto a me. Poi dirà anche a quelli alla sua sinistra: Via, lontano da me, maledetti, nel fuoco eterno, preparato per il diavolo e per i suoi angeli. Perché ho avuto fame e non mi avete dato da mangiare; ho avuto sete e non mi avete dato da bere; ero forestiero e non mi avete ospitato, nudo e non mi avete vestito, malato e in carcere e non mi avete visitato. Anch'essi allora risponderanno: Signore, quando mai ti abbiamo visto affamato o assetato o forestiero o nudo o malato o in carcere e non ti abbiamo assistito?

Ma egli risponderà: In verità vi dico: ogni volta che non avete fatto queste cose a uno di questi miei fratelli più piccoli, non l'avete fatto a me. E se ne andranno, questi al supplizio eterno, e i giusti alla vita eterna » (Mt. 25,31-46).

« Një jetë të jetëve ».

176. I riu: *Si do të jetë pastaj?*

Prifti: Libri i Apokalipsit na zbulon se do të jetë një qiell e një dhe i ri.

Njerëzit do të jetojnë në një qytet të shenjtë, në Jerusalemin qiellor. Atje, siç parashikon Apokalipsi (22,3-5):

« S'do të ketë më gjë të mallkuar.

Atje gjendet froni i Perëndisë... dhe shërbëtorët e tij do ta adhurojnë, do të shohin fytyrën e tij,

dhe në ballë do të mbajnë emrin e tij.

Atje s'do të jëtë më natë.

Nuk do të kenë më nevojë për dritën as të llampës as të diellit,

pse Zoti Perëndia do të shndrisë mbi ta dhe ata do të jetojnë në jetë të jetëve ».

« *Nei secoli dei secoli* ».

176. Il giovane: *Cosa ci sarà dopo?*

Il sacerdote: Il libro dell'Apocalisse ci spiega che ci sarà un cielo nuovo e una terra nuova.

L'umanità vivrà in una città santa, nella Gerusalemme celeste. Là, come predice l'Apocalisse (22,3-5):

« non vi sarà più maledizione.

Il trono di Dio e dell'Agnello

sarà in mezzo a lei

e i suoi servi lo adoreranno;

vedranno la sua faccia

e porteranno il suo nome sulla fronte.

Non vi sarà più notte.

Non avranno più bisogno di luce di lampada,

né di luce di sole,

perché il Signore Dio li illuminerà

e regneranno nei secoli dei secoli ».

SHTOJÇË
APPENDICE



« Liturgjia Hyjnore », afresk i Michel Berger-it (Romë, 1969)

« Divina Liturgia », affresco di Michel Berger (Roma, 1969)

SHTOJCË

Në këtë libër kemi përdorur disa tekste themelore për besën e krishterë, si « Simbolin e Nikesë-Konstantinopojës », lutjen « Ati Ynë », etj, në përkthimin arbëresh të marrë nga « Liturgjia Hyjnore e Atit tonë ndër Shejtrat Joan Hrysostomit », Roma 1968.

Shtojmë këtu përkthimin e këtyre dy teksteve të përdorur nga Ortodoksët dhe nga Katolikët në Shqipëri, në Kosovë, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Tashti që në Shqipëri po riorganizohet kisha do të ishte shumë mirë nëse do të përkthehen së bashku, nga Katolikë dhe Ortodoksë, jo vetëm këto tekste, por në përgjithësi të gjitha Shkrimet e Shenjta të përbashkëta, veçanërisht Besëlidhja e Re.

APPENDICE

In questo sussidio abbiamo usato alcuni testi fondamentali della fede come il « Simbolo Niceno-Costantinopolitano », il « Padre Nostro », ecc. nella traduzione arbëreshe presa dalla « Liturgia Hyjnore e Atit tonë ndër Shejtrat Joan Hrysostomit », Roma 1968.

Aggiungiamo qui questi due testi nella traduzione usata dagli Ortodossi e dai Cattolici in Albania, nella Kosova, negli Stati Uniti d'America.

Ora che in Albania va riorganizzandosi la chiesa sarebbe molto indicato che venissero tradotti insieme, da Cattolici e Ortodossi, non soltanto questi due testi, ma più generalmente tutte le Sacre Scritture che si hanno in comune e specialmente il Nuovo Testamento.

I. SIMBOLI I NIKESË-KONSTANTINOPOJËS

1. Besoj në një Perëndi, At të tërëfuqishmë, krijuës të qiellit dhe të dheut dhe të gjithë të dukurave dhe të padukurave.

Dhe në një Zot, Iisu Krisht, Birin e Perëndisë, të vetëmlindurin, që lindi prej Atit përpara gjithë shekujve. Dritë prej drite, Perëndi të vërtetë, prej Perëndie të vërtetë, të lindur, jo të bërë, që ka të qënë një me Atin, me anën e të cilit u bënë të gjitha.

Që për ne njerëzit edhe për shpëtimin tonë, zbriti prej qiejve, edhe u trupëzua prej shpirtit të shenjtë edhe Virgjëreshës Mari dhe u bë njeri.

Dhe u kryqëzua për ne në kohen e Pontit Pillat, dhe pësoj e u varros.

Dhe u ngjall të tretën ditë sipas shkrimeve. Dhe u ngjit në qiejtë dhe rri në të djathtë të Atit.

Dhe do të vijë përsëri me lavdi të gjykojë të gjallët dhe të vdekurit, mbretëria e të cilit nuk do të ketë mbarim.

Dhe në Shpirtin e Shenjtë, Zot, jetëbërës, që buron prej Atit, që adhurohet e lavdërohet bashkë me Atin e me Birin, që foli me anën e profitëve.

Në një kishë, të shenjtë, të përgjithëshme dhe Apostolike.

Pohoj një pagëzim për ndjesën e mëkatave. Pres ngjalljen e të vdekurve. Dhe jetën e ardhëshme t'amëshuar. Amin.

(*Kisha Orthodoxe Autokefale e Shqipërisë*, nga «Libri i Shërbesave të Shenjta», Tiranë 1961)

2. Besonj më një Perëndi, Atin e tërëfuqishim, krijëtarin e qellit e të dheut e të gjithë të dukurave dhe të padukurave. Dhe më një Zot Jesú Krisht, të vetëmin Bir të Perëndisë, që lindi prej Atit përpara gjithë jëtëve. Dritë prej Drite, Perëndi të vërtetë prej Perëndie të vërtetë që lindi, dhe nuk u-bë, të bashkëqënshim me Atin me anën e të cilit u-bënë të gjitha. Që për ne njerëzit edhe për shpëtimin tonë zbriti prej qellit edhe u-misherua prej Shpirtit Shenjt edhe Virgjëreshës Mari, dhe u-bë njeri. Që u-kryqësua për ne më kohën e Pontit Pilát, edhe vojti, dhe u-varros. Dhe u-ngjall më të tretën ditë pas Shkrónjave. Dhe u-ngjit në qell, dhe ndënji më të djathtën e Atit, edhe do të vinjë prapë me lavdi të gjykonjë të gjallët e të vdekurit, edhe Mbrëterí e tij do mos ketë mbarim. Dhe më Shpirtin Shenjt, Zotin e jetëbërësin, që dërgohet prej Atit, që adhurohet, e lavdërohet me Atin e me Birin, që foli me anën e Profëtëve. Më një Kishë të Shenjtë, të Përgjithëshme dhe Apostollore. Rëfënj një Pagëzim për ndjesën e mëkatave. Pres ngjalljen e të vdekurve dhe jetën e botës që vjen. Amin.

(*Peshkopata Orthodoxe Shqiptare e Amerikës*, nga «Uratore e Kishës Orthodoxe», Boston 1941)

3. Besoj në një Hyj të vetëm, Atin e gjithpushtetshëm, krijuesin e qiellit e të tokës, të gjitha sendeve që shihen e që nuk shihen. Edhe në një Zot të vetëm, Jezu Krishtin, një të vetmin Birin e Hyjit, të lindur prej Atit para të gjithë shekujve. Hyj prej Hyjit, Dritë prej Dritës, Hyj i vërtetë prej Hyjit të vërtetë. Të lindur, jo të krijuar, të njëgjëjtë me Atin: nëpërmjet të cilit u krijuan të gjitha sendet. Ai për ne njerëzit dhe shpëtimin tonë zbriti prej qiellit.

E u mishërua për virtyt të Shpirtit Shenjt në kraharorin e Virgjërës Mari: dhe u bë njeri. Dhe u kryqëzua për ne nën Poncin Pilat; pësoi dhe u varros, dhe u ngjall të tretën ditë sipas Shkrimeve, e u ngrit në qiell dhe rri në të djathtën e Atit. Dhe përsëri do të vijë me lavdi për të gëzuar të gjallët e të vdekurit, e mbretëria e tij nuk do të ketë mbarim. Edhe në Shpirtin Shenjt, që është Zot dhe jetëbërës: Që rrjedh prej Atit e prej Birit. Dhe së bashku me Atin e me Birin adhurohet e lavdërohet, që foli me anën e profetëve. Edhe në një Kishë të vetme, shenjte, katolike dhe apostolike. Dëshmoj një pagëzim të vetëm për faljen e mëkateve. Pres ngjalljen e të vdekurve dhe jetën e pasosur. Amen.

(*Ipeshkvia Katolike « Shkup-Prizren »* (Jugosllavi), nga « Shujta Shpirtërore », Zagreb-Ferizaj, 1987

II. ATI YNË

1. Ati ynë që je në qiejtë, u shenjtëroftë emëri yt, arthtë mbretëria jote, u bëftë dëshira jote si në qiell ashtu edhe mbi dhé, bukën tonë të përditëshme jepnae neve sot dhe falnai fajet tona, sikundër edhe ne u a falim fajtorëve tanë, dhe mos na shtjer në ngasje, po shpëtona nga i ligu.

(*Kisha Orthodoxke Autokefale e Shqipërisë*, nga « Libri i Shërbesave të Shenjta », Tiranë 1961)

2. Ati ynë, që je në qell, u-shenjtëroftë emri yt; arthtë Mbretëria jote; u-bëftë dëshira jote si në qell edhe mi dhé; bukën tonë të përditëshme épnaje neve sot; edhe fálnaji fajet, sikundër edhe né ua falim fajtorëve tanë; edhe mos na shtjer në ngasje, po shpëtona nga i ligu.

(*Peshkopata Orthodoxke Shqiptare e Amerikës*, nga « Uratore e Kishës Orthodoxke », Boston 1941)

3. Ati ynë, që je në qiell, shejtnue kjoftë emni yt. Ardhtë mbretëria jote; u baftë vullnesa jote si në qiell ashtu në dhe. Bukën tonë të përditëshme epna ne sot. E ndiejna ne fajet e mëkatet tona, si i ndiejmë na fajtorët tanë. E mos na len me ra në të keq; por largona prej gjith së keq.

(*Ipeshkvia Katolike « Shkup-Prizren »* (Jugosllavi), nga « Shujta Shpirtërore », Zagreb-Ferizaj, 1987)

PËRMBAJTJA

HYRJE	4
I. BESA E VËRTETË	10
TRINIA E SHENJTË	13
ATI	20
JEZU KRISHTI	24
SHPIRTI I SHENJTË	36
KISHA	40
NJERIU	50
II. JETA SHPIRTËRORE	58
A. SAKRAMENTET	58
1. PAGËZIMI	60
2. KREZMIMI (MIRON)	64
3. KUNGIMI (EUHARISTIA)	70
4. RRËFIMI (KSOMOLLOJSJA)	74
5. MARTESA	78
6. URDHRI I SHENJTË	84
7. VAJI I SHENJTË (EVQELIA)	92
B. LITURGJIA BIZANTINE	96
C. VITI LITURGIK	110
III. UDHA E DREJTË	120
A. URDHËRIMET E T'YNË ZOTI	120
1. « UNË JAM ZOTI, PERËNDIA YT; NUK DO TË KESH TJETËR PERËNDI PËRVEÇ MEJE » ..	126
2. « MOS E PËRMEND PA NDER EMRIN E PERËNDISË »	132
3. « MËBA MEND TË SHENJTËROSH FESTAT » ..	136
4. « NDERO ATIN TËND DHE MËMËN TËNDE » ..	140
5. « MOS VRIT »	144
6. « MOS SHKEL BESËN E MARTESËS »	149
7. « MOS VIDH »	150

INDICE

GELEITWORT	5
I. LA VERA FEDE	11
LA SANTA TRINITA'	14
IL PADRE	21
GESU' CRISTO	25
LO SPIRITO SANTO	37
LA CHIESA	41
L'UOMO	51
II. LA VITA SPIRITUALE	59
A. I SACRAMENTI	59
1. BATTESIMO	61
2. CRESIMA	65
3. EUCARESTIA	71
4. PENITENZA	75
5. MATRIMONIO	79
6. ORDINE SACRO	85
7. OLIO SANTO O EVCHELAION	93
B. LA LITURGIA BIZANTINA	97
C. L'ANNO LITURGICO	111
III. LA RETTA VIA	121
A. I COMANDAMENTI DI DIO	121
1. « IO SONO IL SIGNORE DIO TUO, NON AVRAI ALTRO DIO FUORI CHE ME »	127
2. « NON NOMINARE CON DISONORE IL NOME DI DIO »	133
3. « RICORDATI DI SANTIFICARE LE FESTE » ..	137
4. « ONORA TUO PADRE E TUA MADRE »	141
5. « NON UCCIDERE »	145
6. « NON COMMITTERE ADULTERIO »	149
7. « NON RUBARE »	151

8. « MOS BËJ DËSHMI TË RREME »	154
9. « MOS DËSHIRO GRUAN E TJETRIT »	158
10. « MOS DËSHIRO GJËRAT E TË TJERËVE »	160
B. LUMTURITË E T'YNË ZOTI	164
C. DITA E FUNDIT	170
PËRFUNDIM: « NË JETË TË JETËVE »	174
SHTOJCË	178
1. SIMBOLI I NIKESË-KONSTANTINOPOJËS....	180
2. ATI YNË	183

ILUSTRIMET

- Kopertinë e Roberto Roberti-t (Romë, 1991).
 Faqe 9: Ikonë e Krishtlindjes (Onufri, shek. XVI, Shqipëri).
 Faqe 57: Ikonë e Pagëzimit të Krishtit (Onufri).
 Faqe 119: Ikonë e Shpërftytyrimit të Krishtit (Onufri).
 Ilustrimet e tjera të faqeve 32, 33, 68, 69, 168, 169, janë marrë nga 'Ανθολόγιον (Grottaferrata 1967-1980).
 Faqe 177: Afresk i Michel Berger-it (Romë, 1969).

8. « NON TESTIMONIARE IL FALSO »	155
9. « NON DESIDERARE LA DONNA D'ALTRI »	159
10. « NON DESIDERARE LA ROBA DEGLI ALTRI »	161
B. LE BEATITUDINI	165
C. L'ULTIMO GIORNO	171
CONCLUSIONE: « NEI SECOLI DEI SECOLI »	175
APPENDICE	179
1. SIMBOLO NICENO-COSTANTINOPOLITANO ..	180
2. PADRE NOSTRO	183

ILLUSTRAZIONI

- Copertina di Roberto Roberti (Roma, 1991).
 Pag. 9: Icona della Nascita di Gesù (Onufrio, sec. XVI, Albania).
 Pag. 57: Icona del Battesimo di Gesù (Onufrio).
 Pag. 119: Icona della Trasfigurazione di Gesù (Onufrio).
 Le altre illustrazioni delle pp. 32, 33, 68, 69, 168, 169, sono state prese dall' 'Ανθολόγιον (Grottaferrata, 1967-1980).
 Pag. 177: Affresco di Michel Berger (Roma, 1969).

SUSSIDI CATECHETICI

Arsimi i krishterë është parë gjithmonë nga kisha si një nga detyrat themelore.

Programi i kësaj serie librash ndihmues për mësimin e krishterë parashikon shpjegimin e simbolit të besës, të sakramenteve, të urdhërimeve të Zotit dhe të lutjes liturgjike.

Il programma di questa collana di sussidi catechetici prevede la presentazione del simbolo della fede, dei sacramenti, dei comandamenti di Dio e della preghiera liturgica.

Eleuterio F. Fortino

1. L'iniziazione cristiana nella chiesa bizantina (1985).
2. Il matrimonio nella chiesa bizantina (1986).
3. La penitenza nella chiesa bizantina (1987).
4. L'unzione degli infermi nella chiesa bizantina (1990).
5. Besa e krishterë
Introduzione alla fede cristiana (1992).
6. Il credo nella chiesa bizantina (in preparazione).